

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ AGcompany. ” sh.p.k.**

Sot, më datë 06/11/2024, në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

- Z. OLGËR PRIFTI, atësia Sokol, amësia Vojsava, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë: Rruga E Dibrës; Nd. 66; H. 2; Ap. 47; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 31/10/1985, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 036495411 dhe nr. personal I51031030H;
- Z. ARBER SINANI, atësia Petrit, amësia Besa, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë: Rruga “ Mihal Duri “, Nd.33, H.16, Ap.2; Njësia Administrative Nr. 10; Tiranë, lindur më 11/07/1986, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 039196531 dhe nr. personal I60711062K;

vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

**Neni 1**

**Themelimi**

1.1 Emri i shoqërisë është “ AGcompany. ” Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe statutin.

**Neni 2**

**Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rrugae Kavajës, Kompleksi Parconstruction, Kulla 2, Kati1, Njësia Bashkiake Nr.7, Tiranë.**

2.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

### **Neni 3**

#### **Objekti**

3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

A. Bar - Lounge, snack.

B. Çdo veprimtari tjetër e ligjshme.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

### **Neni 5**

#### **Kapitali Themeltar dhe Ortakët**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (Një qind mije) **Lek**.

5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm:

- **Z. Olger Prifti**, 1 (një) kuotë, me vlerë nominale ALL 50,000 (pesëdhjetë mijë lek), duke përfaqësuar 50% (pesëdhjetë) të kapitalit themeltar me të drejtë vote;

- **Z. Arber Sinani**, 1 (një) kuotë, me vlerë nominale ALL 50,000 (pesëdhjetë mijë lek), duke përfaqësuar 50% (pesëdhjetë) të kapitalit themeltar me të drejtë vote;

5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute nëpara nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.

5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitaline Shoqërisë.

### **Neni 6**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin nëfuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jodakord me këto vendime.

### **Neni 7**

#### **Administratori**

7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.



7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- **Z. Fation Gjergj Beçi**, shtetas Shqiptar, lindur më 20.06.1987, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 033223817 dhe nr. Personal I70620070V.

7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, irinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet ekryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

## **Neni 8**

### **Viti Financiar**

8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo vitikalendariq. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyratfinanciare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

8.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2024.

## **Neni 9**

### **Të ndryshme**

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 4 ( katër ) kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë secila.

## **ORTAKËT**

**Olger PRIFTI**



**Arber SINANI**

